



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike

Plani Kombëtar i Moshimit 2020—2025.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | Postuar më: 27.09.2019

Ne dhjetor 2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, inicioi një proces të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit mbi Moshimin. Procesi ka nisur me një Urdhër Ministri i cili përcakton grupin e punës dhe detyrat. Procesi është drejtuar nga Zj. Merita Xhafaj drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Shëndetësore dhe Sociale.

Takimet individuale me përfaqësues të tre organizatave të pensionistëve dhe organizimi i dy fokus grupeve me gjithsej 21 të moshuar në Tiranë dhe në Vlorë, paraprind përgatitjen e analizës së nevojave dhe identifikimin e fushave prioritare strategjike. Informacioni paraprak i siguruar, lidhet kryesisht me aksesin dhe cilësinë e shërbimeve për të moshuarit.

Pas përgatitjes së një draft dokumenti paraprak ku renditeshin ndërhyrjet prioritare, u organizuan dy konsultime të strukturuar dhe me pjesëmarrje të gjere.

Takimi i parë u organizua në datë me synim përfshirjen në proces të përfaqësuesve të shoqërisë civile sidomos rganizatave të pensionistëve. Në takim u ftuan përfaqësues të shoqatave relevante të renditura më poshtë. Të gjitha shoqatat e pensionereve morren pjesë në takim.

- Bashkimi i Pergjithshem i Pensionisteve te Shqiperise, Faik Xhani
- Unioni i Pensionisteve te Pleqerise, Ferdinand Shkalla
- Shoqata per Integrimin e Pensionisteve, Osman Terziu
- ASAG, Mira Pirdeni
- SANUS -Sherbimi ne familje, Skender Dule
- Shoqata Shqiptare e Geriatrie dhe Gerontologjise, Reshat Koci
- Shoqata e Demografeve te Shqiperise, Ilia Telo
- Shoqata e Gazetareve te Shendetit dhe Ceshtjeve Sociale, Sonila Mlloja
-

Pjesemarresit aprovuan ne pergjithesi fushat prioritare dhe nderhyrjet prioritare te propozuara. Komentet kryesore te paraqitura prej pjesemarresve ishin si me poshte:

- Nevoja per nje ligj te vecante per mbrojtjen sociale dhe shendetesore per pensionistet
- Permiresim I nivelit te pensioneve
- Percaktim zyrtar I minimumit jetik
- Permiresim i aksesit ne transportin urban
- Mbeshtetje nga ana e bashkive per integrimin dhe aktivitetet e te moshuarve

- Mbeshtetje per familjet me te moshuar qe kane semundje kornike dhe humbje te autonomise
- Permiresim i kushteve te strehimit te te moshuarve

Te gjitha sugjerimet, jane reflektuar ne menyre te arsyeshme ne dy fushat e para prioritare te strategjise.

- Keshtu, parashikohet miratimi I minimumit jetik.
- Gjithashtu, parashikohet permiresimi I pershpejtuar I pensioneve minimale dhe harmonizimi I tyre me minimumin jetik.
- Ne nje ojektiv specific te vecante parashikohet subvencionimi I transportit urban per te moshuarit me te varfer (me pension social).
- Strategjia perfshin disa objektiva specifike mbi rritjen e rolit te bashkive ne integrimin dhe aktivitetet sociale te te moshuarve.
- Nje politike prioritare e perfshire ne strategji do te jete integrimi i sherbimeve shendetsores me ato sociale dhe rritja e asistences ne familje.
- Strategjia parashikon gjithashtu rritje te kapaciteteve rezidenciale apo strehimit per te moshuarit me ne nevoje.

Takimi i dyte u organizua ne date.....me synim konsultimin e kapaciteteve dhe nevojave ne nivelin e institucioneve qendrore dhe atyre te qeverisjes vendore, per nderhyrjet prioritare te propozuara ne fushen e moshimit. Ne takim u ftuan perfaqesues te Institucioneve qendrore ne varesi te Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale dhe bashkive

Sherbimi Social Shteteror

Bashkia Tirane

Bashkia Himare

.....

Pjesemarresit aprovuan ne pergjithesi fushat dhe nderhyrjet prioritare te propozuara dhe nenvizuan rolin e qeverive vendore lidhur me moshimin e shendetshem. Komentet kryesore konsistuan ne:

Nevojen per shmangjen e fragmentarizimit te sherbimeve sociale dhe atyre shendetesore lidhur me asistencen per te moshuarit me ne nevoie

shëndetësore kanë në dispozicion për të moshuarit në të rezeje.

Rritjen e kapaciteteve infrastrukturore në nivel bashkie për streha për të moshuarit

Permirosimin e informacionit mbi të moshuarit

Te gjitha sugjerimet, janë reflektuar në mënyrën e duhur në fushën e parë dhe të dytë prioritare të strategjisë.

- Kështu, parashikohet ngritja e shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale në nivel lokal mes bashkëpunimit me të mirë mes bashkive dhe operatoreve shëndetësore
- Parashikohet mbështetja për më shumë qendra ditore për të moshuarit
- Parashikohet permirosim i sistemit të informacionit dhe standartizim i indikatorëve mbi moshimin

Dokumenta:

- [Plani i Moshimit drafti final narrativ 19.09.2019](#)
- [Plani i Moshimit me buxhet final 19.09.2019](#)
- [Plani i Moshimit_Pasaporta e Indikatorëve 10.09.2019](#)

Diskutimet
